

MBIKËQYRJA POLICORE



“REVISTË E AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE, NR.2”

VETTINGU, rinis procesi...

Çfarë duhet të dinë punonjësit e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe AMP!



Veprimtaria hetimore

Flet Drejtorin e Drejtorisë së Hetimit

“Dixhitalizimi dhe Informatizimi i Agjencisë”

Mediat dhe institucionet publike:
info@amp.gov.al
Redaktoi: Hervis Nakuçi
Tel: 0694118209
Email: hervis.nakuci@amp.gov.al



Revista MBIKËQYRJA POLICORE
është botim i Agjencisë së
Mbakëqyrjes Policore.

PËRMBAJTJA

Faqja 3 - Krijimi dhe konsolidimi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

Faqja 4 dhe 5 - Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë së Hetimit në AMP, Z. Altin Curri

Faqja 6 dhe 7 - Mbikëqyrja e strukturave përmes veprimtarisë hetimore

Faqja 8 - Komisioni Disiplinor në AMP si përgjegjësi e shtuar, Funkcionimi dhe
Veprimtaria

Faqja 10 dhe 11 - Intervistë me drejtuesen e Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar/Periodik,
Znj. Ferzilet Osmëni

Faqja 12 - Veprimtaria e Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar/Periodik & Njesisë së Poligrafit

Faqja 13 - Mbikëqyrja e realizuar përmes Inspektimit të Strukturave

Faqja 14 dhe 15 - Hetimi administrativ i Ankesave

Faqja 16 - Dixhitalizimi dhe Informatizimi

Faqja 17 - Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë/Trajnimi i vazhdueshëm i personelit

Faqja 18 - Bashkëpunimi Ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit

Faqja 19 - Sfidat/Prioritetet dhe Objektivat për Vitin 2023

Faqja 20 - Harta e Drejtorive Rajonale të AMP

Faqja 21 - Mënyrat e Komunikimit me qytetarët

Në këtë botim do të gjeni të dhëna statistikore nga puna e sektorëve të veçantë në AMP, lajme nga aktivitete të ndryshme të zhvilluara në kuadër të përgjegjësive ligjore, si edhe informacione të tjera për mediat dhe publikun.

KRIJIMI DHE KONSOLIDIMI I AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE



Gjatë vitit 2022, Agjencia ka vijuar punën për implementimin e Ligjit nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbrojtjes Policore”. Kështu, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me aktin administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm u ngrit Grupi Qendror i Punës dhe 11 Grupe Teknike të Punës për draftimin e paketës së akteve nënligjore në zbatim të tij. Në konsultim me ministrinë e linjës dhe aktorë të tjerë janë hartuar dhe miratuar këto akte nënligjore; 1 Urdhër i Kryeministrit “Për Strukturën e Agjencisë”; 2 Vendime të Këshillit të Ministrave “Për Pagat dhe Rregulloren e Organizimit e Funkcionimit të Agjencisë” dhe 1 Udhëzim i Ministrit të Brendshëm “Për procesin informativ, në funksion të veprimtarisë parandaluese të Agjencisë”.

Miratimi i këtyre akteve nënligjore ishin hapat e para të domosdoshme për vijimësinë e punës së Agjencisë në kuadër të konsolidimit të saj si një strukturë civile e

mbikëqyrjes policore, ndërsa në funksion të një prej përgjegjësive ligjore të shtuara të Agjencisë, atë të Hetimit Disiplinor për “Shkelje të rënda” të subjekteve që janë objekt i veprimtarisë së saj, janë miratuar 3 Urdhëra të Drejtorit të Përgjithshëm, të cilat rregullojnë dhe normojnë procesin e hetimit disiplinor dhe strukturën përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e tyre.

Në aspektin organizativ, pas miratimit të Urdhrit të Kryeministrit “Për miratimin e Strukturës dhe Përbërjes së Re të Agjencisë”, janë mundësuar hapat e mëtejshëm për implementimin e saj, duke u riorganizuar në funksion të përgjegjësive dhe kompetencave të reja ligjore dhe institucionale. Kështu, përgjatë vitit 2022 janë riemëruar 39 punonjës të Agjencisë në detyrat e tyre aktuale, si edhe është kryer procesi i shpalljes së vendeve vakante në Agjenci.

Konkretisht, pas shpalljes së vendeve vakante dhe zhvillimit të procedurave konkurruese për rekrutimin e personelit të ri, për 24 vende vakante të shpallura kanë aplikuar fillimisht 83 aplikantë dhe pas kryerjes së testimit me shkrim, në fazën e intervistës kanë kaluar 31 aplikantë, ndërkohë që fazat e tjera të konkurrimit zhvillohen gjatë vitit 2023.

Aktualisht, Agjencia po vijon punën me procesin e hartimit dhe miratimit të Procedurave Standarde të Punës dhe Përshkrimeve të Punës për çdo veprimtari dhe funksion në strukturat e saj, në të dyja nivelet (vendor e qendror).

Në aspektin funksional, të gjitha strukturat e Agjencisë kanë vijuar në mënyrë të pandërprerë punën për përmbushjen e objektit të veprimtarisë, prioritetëve dhe objektivave të parashikuara në dokumentet strategjike afatmesme, si “Strategjia për Zhvillimin e Agjencisë 2020 – 2024”, “Plani i Veprimit 2020 – 2022”, “Programi Vjetor i AMP-së 2022” si dhe Programi i 300 - ditëve të Ministrisë së Brendshme.

INTERVISTË ME DREJTORIN E DREJTORISË SË HETIMIT NË AMP, Z. ALTIN CURRI



Si ka ndikuar ligji i ri dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në punën aktuale të Drejtorisë së Hetimit dhe cilat janë risitë në raport me rolin e saj në AMP?

Ligji nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, tashmë i pasqyruar dhe në strukturën e AMP, përta i përket Drejtorisë së Hetimit në qendër, e ka konceptuar këtë të fundit si një strukturë, e cila mbikëqyr “Institucionet e veçanta”. Kjo, në kuptimin që Drejtoria e Hetimit, përmes “Sektorit të Mbikëqyrjes së Strukturave të Veçanta” brenda saj, do të mbikëqyrë strukturat në nivel paralel (pra DPPSH-në,

Akademinë e Sigurisë, Institutin e Policisë Shkencore, Gardën e Republikës apo PMNZSH në qendër), ndërsa Drejtoritë Rajonale vijojnë mbikëqyrjen sipas kompetencave territoriale ku ushtrojnë përgjegjësitë. Ky ndryshim pritet të sjellë, cilësi dhe nivel më të lartë për mbikëqyrjen e këtyre institucioneve, të cilat deri tani janë mbuluar sipas nevojave që diktonte një situatë e caktuar.

Gjithashtu, sektor të cilit i është dhënë një rëndësi e veçantë është edhe ai i “Menaxhimit të Burimeve të Informacionit”, i cili ka përgjegjësinë për të menaxhuar dhe administruar burimet e Informacionit, duke funksionuar si Strukturë e Posaçme në veprimtarinë Informativo-gjurmuese dhe duke koordinuar këtë veprimtari me Drejtoritë Rajonale dhe ato në qendër.

Në përfundim, mund të themi se kjo ndarje e përgjegjësiave, pra kompetencat e Drejtorisë së Hetimit dhe autonomia për Drejtoritë Rajonale, përmbush në vetvete parimin “check&balance”, e cila nënkupton se Drejtoria e Hetimit, ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit si strukturë eprore, si për strukturat që janë objekt i veprimtarisë, ashtu edhe për Drejtoritë Rajonale të AMP, kur kjo autorizohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë.

Cili është roli i Drejtorisë së Hetimit në bashkërendimin mes veprimtarive të tjera që ushtrojnë strukturat e AMP?

Drejtoria e Hetimit, në fokusin e Ligjit të ri, realizon dhe duhet të bashkërendojë veprimtarinë e saj me strukturat e tjera të AMP-së. Kjo Drejtoria, e cila kryen hetimin penal, por dhe veprimtarinë Informativo-gjurmuese, është një bosht i rëndësishëm i veprimtarisë së përgjithshme të AMP-së, produkti i të cilës i shërben gjithashtu edhe Vetëqindësimit, Hetimit Disiplinor, Inspektimit dhe procesit të pajisjes së subjekteve me CSP. Gjithashtu, nga ana tjetër, produkti që proceset e përmendura më sipër përftojnë gjatë veprimtarisë së tyre, i shërben Drejtorisë së Hetimit për çeljen e procedimeve penale, apo dhe atyre informativo-gjurmuese.

Tashmë ky bashkërendim ka dhënë rezultatet e tij të prekshme, si në numrin e procedimeve penale, ashtu dhe në cilësinë e nivelin argumentues në Vendimet për pajisjen me CSP të subjekteve, apo vendimeve të Komisionit të Disiplinës në AMP.

Si ka funksionuar bashkëpunimi me Agjencitë e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare?

Bashkëpunimi me Agjencitë homologe ndërkombëtare, jo vetëm që tashmë është konsoliduar, por ka prodhuar dhe produkte konkrete që konsistojnë në hetime/operacione të përbashkëta kundër fenomeneve që kanë prekur vendet respektive. Konkretisht, hetimet e realizuara me homologët tanë në Kosovë (Inspektorati Policor i Kosovës) ku u proceduan/arrestuan 32 punonjës policie dhe 2 shtetas në Shqipëri, si edhe 26 punonjës policie në Kosovë. Gjithashtu, janë zhvilluar takime të përbashkëta në nivel titullarësh me homologët tanë në Greqi, ku janë përcaktuar drejtimet kryesore ku mund të fokusohet ky bashkëpunim.

A ka trajnime periodike të personelit të Drejtorisë së Hetimit në AMP dhe cilat janë nevojat aktuale në këtë aspekt?

Një nga prioritetet e Drejtorisë së Hetimit janë edhe trajnimet, të cilat zhvillohen me qëllim ngritjen e standardeve dhe formimit profesional. Ato kanë shërbyer për të strukturuar në formën e duhur veprimtaritë që ushtron kjo Drejtori, përsa i përket përditësimit dhe rritjes së kapaciteteve në përdorimin e teknologjive bashkëkohore.

Do të veçoja si shumë të rëndësishëm, trajnimin e kryer sëfundmi nga programi ICITAP i Ambasadës së SHBA në Tiranë, në të cilin u zhvilluan teorikisht dhe praktikisht metodologjia/teknikat e Intervistimit, në funksion të hetimit.

Gjithashtu, të rëndësishme janë dhe trajnimet periodike, të cilat konsistojnë në përvetësimin e sistemeve/programeve kompjuterike që përdor aktualisht AMP.

Na tregoni disa shembuj të operacioneve të suksesshme të zhvilluara nga Drejtoria e Hetimit dhe si kanë ndikuar ato tek strukturat që janë objekt i veprimtarisë së Agjencisë?

Nga strukturat e hetimit të Agjencisë, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë/Prokurorisë së Posaçme (SPAK) janë kryer 10 operacione për zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së punonjësve të policisë në format e “Korrupsionit pasiv”, “Shpërdorimit të detyrës”, Favorizimit të “kultivimit të bimëve narkotike” e “Kontrabandës”, dhe tendencave të tjera,

Gjithsesi, ajo që natyrshëm vlen të veçohet, është operacioni i kryer në muajin Prill 2022 në PKK-Morinë. Do ta veçoja këtë operacion, jo vetëm për numrin e madh të të proceduarve, por edhe për faktin se në këtë procedim janë koordinuar dhe aplikuar pothuajse të gjitha format e punës hetimore. Konkretisht, përveç faktit që ishte një hetim që shtrihej në të dyja anët e kufirit, me subjekte nga të dyja vendet (Shqipëri-Kosovë), procesi i të provuarit të veprës penale arriti nivele shume të kënaqshme, pohuar kjo nga SPAK, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku u provua fajësia e të gjithë subjekteve të proceduar.

Ky operacion mjaft kompleks dhe me rezultate shumë të kënaqshme për goditjen e paligjshmërisë nga zyrtarë policorë, u mirëprit jo vetëm nga Ministria e Brendshme, por edhe nga Zëvendës Ndihmës Sekretarja e Shtetit për Çështjet Ndërkombëtare të Drogave dhe Zbatimit të Ligjit, Amb. Lisa Johnson e cila vizitoi Shqipërinë në muajin Korrik, duke shprehur vlerësimet maksimale për Drejtorinë e Hetimit në AMP për suksesin e saj në luftën kundër korrupsionit zyrtar në kufi.

MBIKËQYRJA E STRUKTURAVE PËRMES VEPRIMTARISË HETIMORE

Hetimi procedural penal mbetet një nga shtyllat kyçe të veprimtarisë së Agjencisë. Në këtë kontekst, hetimi procedural penal ka arritur nivele të shkëlqyera në cilësi, por edhe në evidentimin e veprave penale të përcaktuara në Programin Vjetor si prioritare dhe fenomene shqetësuese. Treguesit e veprimtarisë procedurale penale reflektohen në të dhënat e mëposhtme:



Hetimet proaktive të ndjekura nga strukturat e hetimit në nivel vendor e qendror zënë rreth 33% të totalit të referimeve të kryera gjatë vitit 2022. Strukturat e Hetimit të Agjencisë në nivel vendor apo qendror, në interes të dokumentimit të ngjarjeve që kanë ndodhur në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, PMNZSH-në, etj, kanë realizuar edhe veprime me iniciativë, duke kryer arrestime/ndalime në flagrancë për 42 punonjës të strukturave dhe 19 shtetas. Sa i përket hetimeve në ndjekje me SPAK apo Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, sipas vendimeve Penale të Gjykatave, janë ekzekutuar masat e sigurisë si më poshtë vijon:

Masa e sigurimit personal “Arrest në burg” caktuar për 39 persona

- 7 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
- 19 punonjës policie të nivelit zbatues
- 6 punonjës administrativë (civilë)
- 7 shtetas

Masa e sigurimit personal “Arrest në shtëpi” caktuar për 26 persona

- 1 punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues
- 2 punonjës policie i nivelit të parë drejtues
- 15 punonjës policie të nivelit zbatues
- 5 punonjës administrativë (civilë)
- 3 shtetas

Masa e sigumit personal “Pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik” caktuar për 38 persona


- 1 punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues
- 5 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
- 30 punonjës policie te nivelit zbatues
- 2 punonjës dogane (shtetas)

Masa e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” caktuar për 7 persona

- 5 punonjës policie të nivelit zbatues
- 1 efektiv i Gardës së Republikës
- 1 shtetas


Në grafikun e mëposhtëm paraqiten rastet e implikimit në format e paligjshmërisë të shprehura në %:

TRENDI I SHKELJEVE SIPAS VEPRAVE PENALE




Ky grafik reflekton pothuajse të njëjtën tendencë të formave dhe fenomeneve të paligjshmërisë të evidentuar ndër rradhët e strukturave si në vitet e mëparshme, ku përqindjen më të lartë me **29 % të totalit të referimeve** e zënë rastet e përfshirjes në “*korrupsion dhe shpërdorim detyre*”, pasuar me **17% të totalit** rastet e kryerjes së veprave penale “*kundër personit me dashje dhe nga pakujdesia, si dhe kundër familjes dhe 11 % të totalit të referimeve* janë rastet e “*kryerjes së veprimeve arbitrare*”.


TREGUES KRAHASIMOR NR. REFERIMEVE



NR. I SUBJEKTEVE TE REFERUAR



NR. SUBJEKTEVE TË ARRESTUAR/NDALUAR/MASË



KOMISIONI DISIPLINOR NË AMP SI PËRGJEGJËSI E SHTUAR, FUNKSIONIMI DHE VEPRIMTARIA

Ligji nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore” i ka atribuuar Agjencisë përgjegjësi ligjore dhe funksionale të shtuar, e cila është “*Hetimi Disiplinor për shkelje të rënda të punonjësve të strukturave mbikëqyrëse*”. Përgjegjësi kjo, e cila nëpërmjet akteve nënligjore “Rregullorja e Organizimit dhe Funksionit të Agjencisë” miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe akteve normative të Drejtorit të Përgjithshëm, ka filluar të implementohet dhe zbatohet gjatë 4-mujorit të fundit të vitit 2022. Kështu, nga Komisioni Disiplinor i Agjencisë, mbi bazën e sugjerimeve/rekomandimeve të ardhura nga strukturat vendore dhe qendrore të Agjencisë, të cilat gjatë veprimtarive të hetimit administrativ të ankesave e inspektimeve dhe hetimit procedural penal, kanë konstatuar shkelje të karakterit administrativ nga punonjës të strukturave mbikëqyrëse, për fillimin e hetimit disiplinor, vetëm për këtë 4-mujor, ka trajtuar gjithsej 35 praktika, ku në përfundim të shqyrtimit të tyre dhe procesit të hetimit disiplinor, ka rezultuar si më poshtë:

Për 8 praktika është përfunduar hetimi disiplinor dhe është vendosur për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

“Përrjashtim nga Policia”, për 7 punonjës policie

- 1 punonjës i nivelit të parë drejtues, me detyrë shef komisariati policie
- 1 punonjës i nivelit të parë drejtues, me detyrë shef stacioni policie
- 2 punonjës i nivelit të parë drejtues, me detyrë në strukturat e hetimit të krimit
- 1 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e rendit publik
- 2 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e kufirit dhe migracionit

“Shtyrje e afatit të gradimit deri 2 vjet” për 3 punonjës policie

- 1 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e patrullës së përgjithshme
- 1 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë strukturat e kufirit dhe migracionit
- 1 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e policimit në komunitet

“Shtyrje e afatit të gradimit deri 6 muaj” për 2 punonjës policie

- 1 punonjës i nivelit të parë drejtues, me detyrë në strukturat e hetimit të krimit
- 1 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e kufirit dhe migracionit

Për 4 praktika është përfunduar hetimi disiplinor pa masë disiplinore, si më poshtë:

- për 6 punonjës policie, nuk janë konstatuar/provuar shkeljet e pretenduara.
- për 1 punonjës policie, është dhënë vendimi “Përrjashtim nga Policia” nga strukturat e DPPSH.


Për 3 praktika, rekomandim për dhënie mase disiplinore për “Shkelje të lehtë”, si më poshtë:

- 2 punonjës të nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e kufirit dhe migracionit
- 1 punonjës të nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e policimit në komunitet
- 1 punonjës të nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e qarkullimit rrugor

Për 17 praktika është vendosur mosfillim i hetimit disiplinor, si më poshtë:

- për 2 punonjës policie, hetimi disiplinor është filluar nga strukturat e DPPSH
- për 6 punonjës policie, nuk janë konstatuar/provuar shkeljet e pretenduara
- për 8 punonjës, është dhënë vendimi nga strukturat e DPPSH për “Përrjashtim nga Policia”
- për 4 punonjës me status të nëpunësit civil dhe punonjës administrativë, nuk janë subjekt i veprimtarisë së Agjencisë.

INTERVISTË ME DREJTUESEN E DREJTORISË SË VLERËSIMIT KALIMTAR/PERIODIK, ZNJ. FERZILET OSMËNI



Sa prej anëtarëve të Trupave të Vlerësimit në AMP janë vetuar nga Komisioni i Jashtëm për Vettingun në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe AMP?

Me ndryshimet strukturore të miratuara, në Agjenci është krijuar Drejtoria e Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik, ku në përbërje të saj ka edhe Sektorin e Vlerësimit Kalimtar/Periodik (Trupat e Vlerësimit), i cili do të kryejë vettingun e subjekteve të përcaktuara në ligjin 12/2018, i ndryshuar.

Trupa e Vlerësimit përbëhet në total nga 12 anëtarë dhe do të organizohen në 4 trupa vlerësuese me nga 3 anëtarë secila. Të gjithë anëtarët e trupës vlerësuese kanë kaluar me sukses vlerësimin kalimtar (vettingu-n) nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe janë të organizuara në formën e organit kolegjal.

Ligji që njihet si ‘Vettingu në polici’ ka ndryshuar disa herë gjatë viteve të fundit, a mendoni se AMP i ka aktualisht kapacitetet teknike dhe profesionale për të përmbushur këtë detyrim ligjor?

Është e vërtetë që ligji për Vettingun ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, por këto ndryshime kanë ndodhur në kuadër të përmirësimit të ecurisë së procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik. AMP i ka të gjitha kapacitetet e nevojshme për të zhvilluar këtë proces.

Punonjësit e përzgjedhur si anëtarë të trupës vlerësuese pranë AMP-së janë përzgjedhur sipas të gjitha procedurave të parashikuara në Ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 532, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të ligjit. Ata kanë njohuri nga fushat e ekonomisë dhe jurisprudencës, si edhe kanë kryer trajnime në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me tematika që janë me interes për procesin e vettingut. Ndër to mund të përmendim trajnimet e zhvilluar nga ICITAP, OSBE, PAMECA, ILDKPKI, AVOKATI POPULLIT, trajnimi i zhvilluar nga CIDS, etj.

Ky proces u bë për të pastruar uniformat blu nga efektivet e lidhur me krimin dhe ata që nuk justifikojnë pasurinë. A mendoni se ky qëllim është i arritshëm? Po me ata punonjës të strukturave që janë në nivelet më të ulëta si do të veprohet?

Unë besoj fort që ky qëllim, jo vetëm që është i arritshëm, por nga Agjencia janë marrë të gjitha masat që ky proces të vijojë normalisht. Në këtë kontekst, AMP ka riorganizuar strukturat e saj për një proces të pandalshëm, të paanshëm dhe të drejtë, duke u fokusuar tek detyrimet dhe përgjegjësitë e ngarkuara nga ligji, me qëllimin e vetëm që ky proces të japë rezultatet më të larta në përmbushje të misionit të tij.

Referuar nenit 6, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, është përcaktuar që subjektet e vlerësimit janë drejtues të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore. Bazuar në Urdhërin e Ministrit të Brendshëm, strukturat e Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës, kanë detyrimin të dërgojnë pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore listën emërore të subjekteve që

mbajnë funksionet e përcaktuara në nenin 6 të ligjit të vlerësimit, shoqëruar me strukturën organike (rreth 300 subjekte në total). Ky proces aktualisht është në vazhdim e sipër.

Ndryshimet e fundit ligjore, kanë lënë jashtë këtij ligji vlerësimin kalimtar apo periodik për strukturat me grada më të ulëta, apo të rolit bazë. Kjo, bazuar mbi ecurinë e ngadaltë të punës së mëparshme nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. Nga analizat e punës së KJV-së, është provuar se ka patur ngadalësi në trajtimin e rasteve, duke humbur dhe shmangur qëllimin parësor të të gjithë procesit. Kjo ishte dhe arsyeja që solli rishikimin e ligjit dhe korrektimin e listës së subjekteve të deklarimit.

Çfarë masash ka marrë AMP për mbarëvajtjen dhe vijimësinë e këtij procesi?



Agjencia ka ndërmarë një sërë masash në kuadër të zhvillimit të procesit të vettingut, ndër të cilat mund të përmendim miratimin e rregulloreve të ndyshme, të cilat normojnë dhe rregullojnë procedurat dhe veprimtarinë e Trupës Vlerësuese. Në faqen zyrtare të Agjencisë është dedikuar një kategori e veçantë posaçërisht mbi vettingun, në rubrikat e të cilës, publiku mund të njihet me informacione të detajuara dhe shtrruese për çdo aspekt të këtij procesi.

Ndër këto akte të publikuara tashmë, mund të përmendim Ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar, Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e trupave vlerësuese, Rregulloren për hapat proceduralë të unifikuar dhe një sërë Udhëzimesh dhe Rregulloresh të tjera që normojnë këtë proces.

Në çfarë faze ndodhet aktualisht procesi i vettingut në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe AMP?

Aktualisht subjektet e vlerësimit kanë plotësuar Formularët e Deklarimit për vlerësimin kalimtar. Këta formularë janë të publikuar në faqen zyrtare të AMP, www.amp.gov.al.

Pas përfundimit të fazës së parë të plotësimit të formularëve, AMP zhvilloi një proces të ri shortimi bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm. Menjëherë pas hedhjes së shortit, Trupat Vlerësuese kanë filluar procedurat e parashikuara, përfshi dërgimin e formularëve përkatës tek institucionet ndihmëse, të cilat janë të përcaktuara në ligjin 12/2018, i ndryshuar.

Çfarë do të ndodhë me deklaratat e dorëzuara me herët?

Ministri i Brendshëm ka nxjerrë Urdhër, ku strukturat përgjegjëse të burimeve njerëzore të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës, kanë marrë në dorëzim nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, formularët e deklarimeve të plotësuar më parë dhe dokumentacionin e administruar për subjektet për të cilët nuk ka një vendim përfundimtar dhe do tua shpërndajnë subjekteve respektive.

VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË VLERËSIMIT KALIMTAR/ PERIODIK & NJËSISË SË POLIGRAFIT



Duke qenë se personeli i Agjencisë është subjekt i ligjit nr.12/2018, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit (KJV) ka filluar gjatë vitit 2022 procesin e vlerësimit kalimtar për punonjës të Agjencisë, anëtarë të trupave vlerësuese, ku nga momenti i shortimit dhe deri në fund të vitit janë dhënë 28 vendime, nga të cilët:

- Për 21 punonjës është vendosur “konfirmim në detyrë”,
- Për 2 punonjës është vendosur “ndjekje e trajnimit profesional”,
- Për 4 punonjës është vendosur “ndërprerje e procesit të vlerësimit”
- Për 1 punonjës është vendosur “përfundim nga detyra”.

Në cilësinë e Autoritetit Vlerësues, që Agjencia gëzon nga ligji 12/2018 i ndryshuar, por dhe ligji organik i saj nr. 128/2021, gjatë këtij viti është fokusuar vëmendja në bashkëpunim dhe me strukturat përkatëse të Ministrisë së Brendshme, duke synuar rregullimin e disa procedurave dhe standardeve që lidhen me:


- reduktimin dhe kufizimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin 12/2018 dhe kryerjen e procesit të vlerësimit nëpërmjet një strukture permanente vlerësimi për zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s;*
- përcaktimin e një afati ligjor për kryerjen e procesit të vlerësimit;*
- futjen në rol të institucioneve të tjera ndihmëse në proces, si ILDKPKI;*
- plotësimin e vakumeve ligjore;*
- standardizimin dhe detajimin e procedurave të vlerësimit për të tre komponentët: pasuri, figurë dhe profesionalizëm;*
- parashikimin e sanksioneve ligjore për t'i dhënë fuqi detyruese zbatimit të vendimit të trupave të vlerësimit nga institucionet përkatëse;*
- parashikimin e procedurave të dorëzimit dhe arkivimit të dosjeve të shorteve të papërfunduara nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.*

Grupi i punës së ngritur me Urdhër të Ministrit të Brendshëm draftoi projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 12/2018 “Për Vetungun”, i cili iu nënshtrua mendimeve dhe sugjerimeve të institucioneve të linjës, konsultimit publik dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Këto ndryshime dhe shtesa janë miratuar me ligjin nr. 78/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme”, i ndryshuar”, i cili ka hyrë tashmë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare, nr. 165, datë 13.12.2022.

Sa e besueshme është?


Sipas Shoqatës Ndërkombëtare të Poligrafit, besueshmëria e përfundimeve të nxjerra nga një ekzaminim poligrafik shkon nga 88-97% saktësi



Gjithashtu, në kuadër të projektit risi për vendin tonë, ai i “Testimit Poligrafik”, Njësia Poligrafike e certifikuar e Agjencisë, në zbatim të një marrëveshje të nënshkruar ndërmjet institucionit tonë dhe agjencive ligjzbatuese dhe inteligjente në vend, ka kryer ekzaminimin poligrafik të 121 punonjësve, në funksion të procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës dhe kushtit të sigurisë.


MBIKËQYRJA E REALIZUAR PËRMES INSPEKTIMIT TË STRUKTURAVE

Agjencia ka programuar dhe realizuar veprimtarinë inspektuese si pjesë e mbikëqyrjes dhe monitorimit, e cila siguron përmbushjen e detyrave institucionale dhe parandalimin e veprimtarisë së kundërligjshme të kryera nga subjekte, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë administrative apo penale për subjektet përgjegjëse. Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar gjithsej **117 inspektime**, prej të cilave:




Në përfundim të veprimtarisë inspektuese, për mangësitë e konstatuara janë dhënë 152 rekomandime për përmirësimin e punës së këtyre strukturave. Në 6 raste janë referuar materialet procedurale në Prokurori për 9 punonjës policie, nga të cilët; 5 punonjës të nivelit të parë drejtues dhe 4 punonjës të nivelit zbatues. Në 20 raste është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor për 77 punonjës policie, nga të cilët 5 punonjës të nivelit të mesëm drejtues, 37 punonjës të nivelit të parë drejtues, 33 punonjës policie të nivelit zbatues dhe 2 punonjës administrativë.

Referuar shërbimeve, nga 117 inspektimet e kryera rezulton se:




Të dhëna krahasuese sipas viteve:




Periudha	Numri i inspektimeve		Struktura	Rekomandime	H. Disiplinore	Referime
	Planifikuara	Paplanifikuara				
Viti 2020	29	59	62	282	83 punonjës	2 punonjës
Viti 2021	43	67	72	439	288 punonjës	2 punonjës
Viti 2022	16	101	117	152	77 punonjës	9 punonjës

HETIMI ADMINISTRATIV I ANKESAVE




Agjencia, ka siguruar kushtet e përshtatshme për marrjen, administrimin dhe trajtimin e ankesave, të cilat adresohen nëpërmjet telefonatave pranë Linjës së Gjelbër (08009090), paraqitjes së qytetarëve pranë Zyrës së Ankesave, adresës E-mail (ankesa@amp.gov.al), postës zyrtare, raportimeve në aplikacionin “Komisariati Digital”, institucioneve të ndryshme dhe publikimeve në media

Gjatë vitit 2022 janë marrë 4686 telefonata në linjën e gjelbër 0800 90 90, si dhe janë administruar 1970 ankesa, për të cilat është kryer regjistrimi në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes/Moduli i Hetimit të Ankesave.



DINAMIKA E ANKESAVE SIPAS SHËRBIMEVE




Siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm, numri më i madh i ankesave i përket shërbimeve të policisë të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarin, siç janë strukturat e Sigurisë Publike, Policisë Rrugore apo Hetimit të Krimit, të cilët janë më të riskuar edhe në aspektin e veprimeve korruptive.

Sipas treguesve statistikorë të paraqitur në grafikun e mëposhtëm, nga sa vërehet prej trendit të shkeljeve të mundshme të kryera nga punonjësit e strukturave, të adresuara nëpërmjet denoncimeve të

publikut pranë Agjencisë, rezulton se numri më i lartë i ankesave është për vendosjen e masave administrative dhe veprime arbitrare (këtu përfshihen shoqërime të padrejta, dhunë fizike ose psikologjike, shkelje të normave të etikës, etj).


Krahasuar me vitin 2021, ky trend rezulton të jetë pothuajse në të njëjtat vlera, por vërehet një rritje e denoncimeve/ankesave në drejtim të krimit mjedisor (zhurma/ ndërtim i paligjshëm/prerje e drurëve, etj).

Të ndara sipas tendencës së shkeljeve të raportuara, gjendja paraqitet si vijon:




Në përfundim të hetimeve, në **44 raste** është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor për **58 punonjës** policie, nga të cilët 1 punonjës i nivelit të mesëm drejtues, 14 punonjës të nivelit të parë drejtues, 42 punonjës të nivelit zbatues, 1 punonjës administrativ. Sipas strukturave ata ndahen si më poshtë vijon:

SUGJERUAR FILLIMI I HETIMIT DISIPLINOR (SIPAS STRUKTURAVE)




DIXHITALIZIMI DHE INFORMATIZIMI



Dixhitalizimi dhe rritja e kapaciteteve të Agjencisë nëpërmjet aplikimit të teknologjive bashkëkohore të informacionit, aktualisht është kryer me fondet buxhetore dhe donacionet nga partnerët tanë më të ngushtë (si ICITAP). Për këtë qëllim janë realizuar projekte për sigurimin dhe vënien në efikasitet të sistemeve të reja analitike të informacionit iBase & i2 Analyst Notebook, si edhe sistemit të Menaxhimit të Çështjes Moduli i Ankesave/ Moduli i Hetimit Procedural Penal. Këto sisteme i shërbejnë rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të proceseve informative, analizës së informacionit, hetimit administrativ dhe atij procedural penal që kryhet nga strukturat e Agjencisë, ashtu sikurse edhe rritjes së mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë dhe llogaridhënies sipas linjës epror-vartës, për përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi funksionale të gjithsecilit.

Gjatë vitit 2022 është punuar për konfigurimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit iBase (SMI Ibase) sipas kërkesave dhe në përshtatje me mënyrën e organizimit strukturor të Agjencisë, si dhe përcaktimeve në aktet nënligjore që normojnë veprimtarinë informative-gjurmuese.



Një theks i veçantë i është dhënë edhe sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të Agjencisë. Kjo, nisur nga njëra anë prej sulmit kibernetik që pësoi rrjeti i institucioneve kryesore shqiptare (AKSHI) dhe nga ana tjetër, nga natyra e veprimtarisë sensitive dhe konfidenciale që performojnë strukturat e Agjencisë në përmbushje të objektit të veprimtarisë së saj. Kështu, nëpërmjet prokurimit të klasifikuar me objekt “Blerje pajisje për arkivën dixhitale, ndarjen e saj më vete dhe instalim, konfigurim dhe implementim brenda rrjetit të Agjencisë”, u mundësua plotësimi sipas kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto procedura për rrjetet që qarkullojnë informacion të klasifikuar.

FORCIMI I KAPACITETEVE TË AGJENCISË/TRAJNIMI I VAZHDUESHËM I PERSONELIT

Në kuadër të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të brendshme të Agjencisë, nëpërmjet bashkëpunimit me organizma të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit janë zhvilluar një sërë trajnimesh me tematika të ndryshme, në kuadër të thellimit të njohurive mbi fusha të ndryshme që janë pjesë e punës së përditshme të punonjësve tanë.



Kështu, në periudhën Mars – Qershor 2022, 10 punonjës të Agjencisë morën pjesën në trajnimin e zhvilluar në Akademinë ILEA, Budapest, Hungari. Tematika e këtij trajnimi është e fokusuar në çështje që lidhen me “*Luftën kundër korrupsionit publik*”. Trajnimi është financuar nga ICITAP.



Në periudhën 13 – 15 Qershor 2022 dhe 1 – 2 Shtator, 2 punonjës të Agjencisë morën pjesë në trajnim e zhvilluar në Vilnius, Lituani, me temë “*Analizimi i të dhënave të mëdha (Big data) për të parandaluar e zbuluar korrupsionin dhe mashtrimin që prekin interesat financiare të BE-së*”.



Ky trajnim i zhvilluar në kuadër të projektit të Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), u fokusua në identifikimin e rreziqeve të korrupsionit dhe mashtrimit duke përdorur mjetet e analizës së të dhënave të mëdha (Big Data). Trajnimi u realizua nga ekspertë të SHBA, Zvicrës e Hungarisë dhe kishte për qëllim forcimin e kompetencave të Shërbimeve Speciale të Hetimit dhe profesionistëve të tjerë të zbatimit të ligjit në parandalimin e rreziqeve të korrupsionit që prekin interesat financiare të Bashkimit Europian, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për shkëmbimin e informacionit

Në datat 29 – 30 Shtator 2022, një punonjës i Agjencisë, njëkohësisht dhe personi i kontaktit/anëtari i grupit të punës pranë MD, mori pjesë në trajnimin me tematikë “*Organizimi, menaxhimi dhe koordinimi i punës me grupet e interesit (stakeholders)*”, i organizuar nga Drejtoria e Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë me një bashkëpunim me Projektin e Asistencës Teknike për Antikorrupsionin, të Delegacionit të Bashkimit Evropian. Objektivi i seminarit ishte prezantimi i pjesëmarrësve me paketën e mjeteve dhe metodave për kryerjen e identifikimit dhe vlerësimit të palëve të interesuara, si edhe ofrimi i njohurive kryesore se si të zhvillojnë një plan menaxhimi të palëve të interesuara.

Rreth 30 punonjës të AMP kanë marrë pjesë në një seri seminaresh/trajnimesh të organizuara nga CIDS (Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes) në kuadër të implementimit të projektit “*Promovimi i Integritetit dhe Qeverisjes së Mirë në Vendet e Ballkanit Perëndimor*”.

Këto seminare/trajtime u zhvilluan në harkun kohor prej 5 muajsh, ku u identifikuan nevojat parapërgatitore dhe u vlerësuan kapacitetet për procesin e vlerësimit të pasurisë së subjekteve të ligjit, në kontekstin e parimeve themelore për zhvillimin e ekzaminimeve dhe analizave financiare, në kuadër të hetimeve të ndryshme për identifikimin e mashtrimeve, sipas qasjes së Shoqatës së Egzaminuesve të Certifikuar të Mashtrimeve (ACFE), me bazë në Texas, SHBA.

Punonjësit e Agjencisë u trajnuan mbi aspektet praktike të vlerësimit të pasurisë, duke u fokusuar në aspekte thellësisht teknike dhe duke trajtuar modelimin e analizës financiare në përshtatje me kërkesat e legjislacionit për vlerësimin kalimtar dhe periodik.

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL BRENDA DHE JASHTË VENDIT

Agjencia ndër vite dhe në mënyrë të vazhdueshme është mbështetur nga programet dhe misionet e huaja brenda dhe jashtë vendit në rrugën e saj drejt konsolidimit si një Agjenci e Mbikëqyrjes së Jashtme Policore, si dhe reformave të vazhdueshme institucionale dhe përshtatshmërive ligjore, organizative e funksionale. Mbështetja e dhënë ka qenë e fokusuar në asistencën ligjore për ligjin e ri organik të Agjencisë, trajnime për personelin e saj, si dhe donacione për pajisje e sisteme kompjuterike.



Agjencia ka bashkëpunuar dhe vazhdon të ketë një bashkëpunim të ngushtë me misionet, programet apo edhe agjencitë tona homologe si; OSBE, PAMECA, CIDS, ILEA, EPAC, IPK, ICITAP, etj.

Është për t'u vlerësuar bashkëpunimi dhe ndihma e dhënë nga ICITAP, në draftimin e ligjit të ri të Agjencisë, trajnimeve të vazhdueshme për personelin e ri të Agjencisë sonë dhe të personelit ekzistues dhe në veçanti për donacionin për ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Çështjes me modulet e saj, atë të Hetimit Administrativ të Ankesave dhe Hetimit Procedural Penal.



EPAC (Partnerët European Kundër Korrupsionit), rrjeti që bën bashkë 70 Autoritete antikorrupsion dhe organizma të mbikëqyrjes policore nga vendet anëtare të Këshillit të Europës me qëllimin e vetëm, parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Agjencia, anëtare me të drejta të plota në këtë rrjet, prej vitit 2010 është angazhuar në shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira për hartimin e Manualeve Standarde të Punës për të dy kategoritë e institucioneve, si Agjencitë Antikorrupsion, ashtu edhe Agjencitë e Mbikëqyrjes Policore, Buletineve Periodike mbi aktivitetet apo risitë e reja ndër vendet anëtare si në aspektet ligjore, organizative e funksionale.



IPK (Inspektorati Policor i Kosovës) në bazë dhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve tona, bashkëpunimi ynë është shtrirë në të gjitha drejtimet, nga shkëmbimi i

eksperiencave më të mira në fushat respektive të veprimtarisë, në zhvillimin e inspektimeve tematike dhe sidomos në hetime penale të suksesshme, siç ishte Operacioni "PIKA 2", i kryer në bashkëpunim ndërmjet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP), Departamentit të Policisë Kufitare e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në koordinim me Prokurorinë Speciale dhe Inspektoratin Policor (IPK) të Republikës së Kosovës.

SFIDAT/PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023

Në përmbushje të prioriteteve dhe objektivave përkatëse të parashikuar në “Strategjinë për Zhvillimin e Agjencisë 2020 – 2024”, nëpërmjet të cilave do të arrihet konsolidimi organizativ dhe funksional i Agjencisë, gjatë vitit 2023, veprimtaria e strukturave tona do të fokusohet kryesisht në këto drejtime:

- ❖ **Vijimi i konsolidimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**, nëpërmjet përfundimit të hartimit dhe miratimit të paketës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 128/2021 për Agjencinë, si; Vendime të Këshillit të Ministrave, Udhëzime të Ministrit të Brendshëm dhe akteve normative në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm.
- ❖ **Implementimi i strukturës dhe përbërjes së re organike të Agjencisë**, e riorganizuar në funksion të përgjegjësi dhe kompetencave të reja ligjore dhe institucionale.
 - Riemërimi në detyrë i personelit aktual të Agjencisë,
 - Shpallja e fituesve dhe emërimi në detyrë i personelit të ri,
 - Trajnim bazë në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë dhe institucione të tjera ligjzbatuese dhe inteligjente në vend.
- ❖ **Vazhdimi i Implementimit të “Strategjisë për Zhvillimin e Agjencisë 2020 – 2024”**
 - Analiza e realizimit dhe mosrealizimit të objektivave, masa konkrete të Planit të Veprimit 2020 – 2022.
 - Hartimi dhe miratimi i Planit të ri të Veprimit 2023 – 2024 në kuadër të Strategjisë për Zhvillimin e Agjencisë”.
 - Implementimi dhe zbatimi i masave dhe detyrave të parashikuara në Planin e ri të Veprimit.
- ❖ **Fillimi i procesit të Vetëingut** – pas miratimit të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 12/2018, me ligjin nr. 78/2022, datë 17.11.2022
 - Rishikimi i akteve nënligjore të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm që normojnë këtë veprimtari, në përputhje me ligjin e ri që do të miratohet,
 - Marrja në dorëzim e gjithë dosjeve të administruara nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit,
 - Fillimi i procesit të vlerësimit sipas përcaktimeve, kategorive dhe mënyrës së përcaktuar në ligjin e ri.
- ❖ **Hetimi disiplinor** i punonjësve të strukturave mbikëqyrëse, për shkeljet e rënda të konstatuara gjatë veprimtarive të Agjencisë.
 - Zhvillimi i hetimit disiplinor për rastet e konstatuara.
- ❖ **Hetimi administrativ i ankesave dhe inspektimeve**
 - Përmirësimi i sistemit të Menaxhimit të Ankesave me modulën e inspektimit dhe paralajmërimit të hershëm.
 - Zhvillimi i inspektimeve mbi bazë analize risku dhe kryesisht në ato struktura me risk më të lartë korrupsioni apo implikimin në forma të tjera paligjshmërie;
- ❖ **Hetimi procedural penal & analiza e informacionit kriminal**
 - Implementimi i rregullave, normave dhe procedurave të reja të parashikuara në aktin nënligjor të Ministrit të Brendshëm në aplikimin e procesit informativ, në funksion të veprimtarisë parandaluese,
 - Vënia në efikasitet e bazës së të dhënave të Agjencisë nga strukturat e hetimit në nivel qendror dhe vendor,
 - Draftimi dhe miratimi i manualeve dhe procedurave standarde të punës për përdorimin e kësaj baze të dhënash,
 - Trajnimi i personelit për përdorimin e tij,
 - Ndjekja me prioritet e hetimeve proaktive që ndiqen me Prokurorinë e Posaçme (SPAK), por dhe prokuroritë e tjera.
- ❖ **CSP – kushti i sigurisë dhe pastërtia e figurës** për personelin e subjekteve mbikëqyrëse dhe jo vetëm;
 - Implementimi i normave, procedurave dhe rregullave të parashikuara në aktet nënligjore të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm që rregullojnë këtë veprimtari të AMP-së, në përputhje me ligjin e ri organik,
 - Ndjekja dhe kryerja e procedurave aplikuese dhe verifikuese për kushtin e sigurisë për personelin e strukturave mbikëqyrëse.
- ❖ **Proceset Integruese të Shqipërisë në Bashkimin Evropian/bashkëpunimi ndërinstitutional**
 - Përmbushja e detyrimeve të Agjencisë që rrjedhin nga Strategjitë Ndërsektoriale dhe Planet Konkrete të Veprimit.
 - Angazhimi i vazhdueshëm në Grupet Ndërinstitutionale të Punës për ndjekjen dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga rekomandimet e lëna nga Bashkimi Evropian për institucionet shqiptare, në kuadër të aderimit të Shqipërisë në BE.

HARTA E DREJTORIVE RAJONALE TË AMP

Drejtoria Rajonale AMP Tiranë

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Tiranë ndodhen në ambjentet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Adresa: Rr. Sami Frashëri Nr.5, Tiranë
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Drejtoria Rajonale AMP Durrës

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Durrës ndodhen në ambjentet e DVP Durrës.

Adresa: Rr. Aleksandër Goga, Durrës
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Drejtoria Rajonale AMP Shkodër - Lezhë

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Shkodër ndodhen në ambjentet e DVP Shkodër.

Adresa: Rr. Lëvizja e Postribës, Shkodër
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Zyrat e AMP në Lezhë

Zyrat e AMP Lezhë ndodhen në ambjentet e DVP Lezhë.

Adresa: Rr. Luigj Gurakuqi, Lezhë 4501
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Drejtoria Rajonale AMP Kukës - Dibër

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Kukës ndodhen në ambjentet e DVP Kukës.

Adresa: Lagjia Nr.6, Rr. "Sul Elezi", Kukës
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Zyrat e AMP në Dibër

Zyrat e AMP Dibër ndodhen në ambjentet e DVP Dibër.

Adresa: Lagjia "Gjokë Doçi", Rr. Iljaz Pashë Dibra, Peshkopi
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Drejtoria Rajonale AMP Fier - Berat


Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Fier ndodhen në ambjentet e DVP Fier.

Adresa: Rr. Koco Plaku, Fier
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Zyrat e AMP në Berat

Zyrat e AMP Berat ndodhen në ambjentet e DVP Berat.

Adresa: Blv. "Republika", Berat
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90



Drejtoria Rajonale AMP Elbasan - Korçë

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Elbasan ndodhen në ambjentet e DVP Elbasan.

Adresa: Rr. Koço Brisku, Elbasan
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Zyrat e AMP në Korçë

Zyrat e AMP Korçë ndodhen në ambjentet e DVP Korçë.

Adresa: Lagjia Nr.1, Blv. "Republika", Korçë
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Drejtoria Rajonale AMP Vlorë - Gjirokastrë

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Vlorë ndodhen në ambjentet e DVP Vlorë.

Adresa: Lagjia "Kushtrimi", Rr. Janaq Kilica
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Zyrat e AMP në Gjirokastrë

Zyrat e AMP Gjirokastrë ndodhen në ambjentet e DVP Gjirokastrë.

Adresa: Lagjia "18 Shtatori"
Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT



Denonco paligjshmërinë nga punonjës të:

Policisë së Shtetit
Gardës së Republikës
Shërbimit Zjarrfikës (PMNZSH)

Posta elektronike

ankesa@amp.gov.al

Linja e Gjelbër:

0800 90 90 (pa pagesë)

Për denoncime në kuadër të Vettingut në Polici: denonco@amp.gov.al

Posta zyrtare: Rruga “Asim Vokshi”, Nr. 19/1, Tiranë

Zyra e Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP

Zyrat e Drejtorive Rajonale të AMP pranë Drejtorive Vendore të Policisë në Qarqe

Faqja zyrtare në Internet e AMP: www.amp.gov.al

Faqet në rrjetet sociale: AMP në Facebook, Instagram, Twitter dhe LinkedIn

